



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 nëntor 2017  
Nr. ref.: RK 1155/17

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastet nr. KI73/17, KI78/17 dhe KI85/17**

Parashtrues

**Istref Rexhepi dhe 28 të tjerë**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së 29 aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës të nxjerra ndërmjet 7 shkurtit dhe 20 marsit 2017**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare.

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa KI73/17 është dorëzuar nga 27 parashtrues të kërkesës, përkatësisht: Istref Rexhepi, Lulferet Hoxha, Aziz Balaj, Azem Veliu, Adem Veliu, Mehmet Buzhala, Latif Shaqiri, Elfije Gashi, Ilaz Ahmeti, Enver Hamza, Bajram Salihu, Bahtir Geci, Shaqir Bejta, Halil Sejdiu, Florim Haliti, Sherife Halili, Lah Sahiti,

Naser Rama, Halim Meha, Asllan Bajra, Zymer Halilaj, Sadik Ahmeti, Abaz Avdiu, Ahmet Hoti, Muhamet Gashi, Januz Gashi, dhe Enver Mëziu, të përfaqësuar nga Jahir Bejta, drejtor i OJQ-së “Ngritja e Zërit”, me banim në Skenderaj.

2. Kërkesa KI78/17 është dorëzuar nga Behram Kajtazi.
3. Kërkesa KI85/17 është dorëzuar nga Sokol Goxhuli. Të gjithë të lartcekurit (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës) janë me banim në Skenderaj.

### **Vendimi i kontestuar**

4. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë 29 vendime të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) si në vijim:
  1. Istref Rexhepi - Aktvendimi Rev. nr. 430/2016 i 16 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 16 mars 2017;
  2. Lulferet Hoxha - Aktvendimi Rev. nr. 387/2016 i 8 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 11 prill 2017;
  3. Aziz Balaj - Aktvendimi Rev. nr. 414/2016 i 13 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 15 mars 2017;
  4. Azem Veliu - Aktvendimi Rev. nr. 432/2016 i 8 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 15 mars 2017;
  5. Adem Veliu - Aktvendimi Rev. nr. 420/2016 i 16 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 15 mars 2017;
  6. Mehmet Buzhala - Aktvendimi Rev. nr. 421/2016 i 7 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 25 shkurt 2017;
  7. Latif Shaqiri - Aktvendimi Rev. nr. 386/2016 i 7 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 28 shkurt 2017;
  8. Elfije Gashi- Aktvendimi Rev. nr. 390/2016 i 16 marsit 2017, i cili i është dorëzuar asaj më 16 mars 2017;
  9. Ilaz Ahmeti - Aktvendimi Rev. nr. 391/2016 i 7 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 28 shkurt 2017;
  10. Enver Hamza - Aktvendimi Rev. nr. 392/2016 i 8 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 15 mars 2017;
  11. Bajram Salihu - Aktvendimi Rev. nr. 396/2016 i 7 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 3 mars 2017;
  12. Bahtir Geci - Aktvendimi Rev. nr. 427/2016 i 9 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 15 mars 2017;
  13. Shaqir Bejta - Aktvendimi Rev. nr. 407/2016 i 8 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 15 mars 2017;
  14. Halil Sejdiu - Aktvendimi nr. Rev 411/2016 i 7 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 2 mars 2017;
  15. Florim Haliti - Aktvendimi Rev. nr. 397/2016 i 8 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 25 mars 2017;
  16. Sherife Halili - Aktvendimi nr. Rev 419/2016 i 16 marsit 2017, i cili i është dorëzuar atij në një datë të pacaktuar;
  17. Lah Sahiti - Aktvendimi Rev. nr. 429/2016 i 16 marsit 2017, i cili i është dorëzuar atij në një datë të pacaktuar;

18. Naser Rama - Aktvendimi Rev. nr. 424/2016 i 16 marsit 2017, i cili i është dorëzuar atij në një datë të pacaktuar;
19. Halim Meha - Aktvendimi Rev. nr. 401/2016 i 7 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 28 shkurt 2017;
20. Asllan Bajra - Aktvendimi Rev. nr. 406/2016 i 7 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 28 shkurt 2017;
21. Zymer Halilaj - Aktvendimi Rev. nr. 422/2016 i 8 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 24 mars 2017;
22. Sadik Ahmeti - Aktvendimi Rev. nr. 409/2016 i 13 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 11 prill 2017;
23. Abaz Avdiu - Aktvendimi Rev. nr. 394/2016 i 7 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 28 shkurt 2017;
24. Ahmet Hoti - Aktvendimi Rev. nr. 433/2016 i 16 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 16 mars 2017;
25. Muhamet Gashi - Aktvendimi Rev. nr. 410/2016 i 16 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 16 mars 2017;
26. Januz Gashi - Aktvendimi Rev. nr. 412/2016 i 8 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 16 mars 2017;
27. Enver Mëziu - Aktvendimi Rev. nr. 425/2016 i 16 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 15 mars 2017;
28. Behram Kajtazi, - Aktvendimi Rev. nr. 398/2016 i 20 marsit 2017, i cili i është dorëzuar atij në një datë të pacaktuar; dhe
29. Sokol Goxhuli - Aktvendimi Rev. nr. 416/2016 i 7 shkurtit 2017, i cili i është dorëzuar atij më 10 shkurt 2017.

### **Objekti i çështjes**

5. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, me të cilat pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe neni 15 i Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

### **Baza juridike**

6. Kërkesat bazohen në paragrafin 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 23 qershor 2017, 27 parashtrues dorëzuan kërkesën KI73/17 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 28 qershor 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka Nimani.
9. Më 5 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës Behram Kajtazi dorëzoi kërkesën KI78/17 në Gjykatë.
10. Më 7 korrik 2017, në pajtim me rregullin 37.1 të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI78/17 me kërkesën KI73/17. Me këtë urdhër, u vendos që gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jetë e njëjtë me atë që ishte vendosur nga Kryetarja për caktimin e gjyqtarit raportues dhe Kolegjit shqyrtues më 28 qershor 2017.
11. Më 17 korrik 2017, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin dhe bashkimin e kërkesave dhe kërkoi që të dorëzojnë dokumente shtesë në Gjykatë.
12. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesave Gjykatës Supreme dhe dërgoi kërkesë në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) për të paraqitur dëshmi lidhur me datën e pranimit të vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme nga 22 (njëzet e dy) parashtrues të kërkesës.
13. Më 21 korrik 2017, Gjykata pranoi nga parashtruesit e kërkesës disa nga dokumentet e kërkuara prej saj më 17 korrik 2017.
14. Të njëjtën ditë, Gjykata dërgoi një kopje të dokumenteve shtesë në Gjykatën Supreme dhe dërgoi një kërkesë në Gjykatën Themelore për të paraqitur datën e pranimit të vendimeve të kontestuara të Gjykatës Supreme nga 2 (dy) parashtrues që nuk i ishin bashkëngjitur kërkesës.
15. Më 24 korrik dhe 11 gusht 2017, Gjykata Themelore i dorëzoi Gjykatës fletëkthesat të cilat tregojnë datat kur 22 (njëzet e dy) parashtrues kishin pranuar vendimet e kontestuara, siç u kërkua nga Gjykata më 17 korrik 2017.
16. Më 27 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës Sokol Goxhuli parashtrroi kërkesën KI85/17 në Gjykatë.
17. Më 28 korrik 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
18. Më 4 gusht 2017, Gjykata pranoi nga parashtruesit e kërkesës dokumentet shtesë të kërkuara më 17 korrik 2017.

19. Më 7 gusht 2017, Gjykata Themelore dorëzoi në Gjykatë fletëkthesat që tregojnë datën kur 2 (dy) parashtrues të kërkesës kishin pranuar vendimet e kontestuara, siç ishte kërkuar nga Gjykata më 21 korrik 2017.
20. Të njëjtën ditë, në pajtim me rregullin 37.1 të Rregullores së punës, Kryetarja e Gjykatës urdhëroi bashkimin e kërkesës KI85/17 me kërkesat KI73/17 dhe KI78/17. Me këtë urdhër, u vendos që gjyqtari raportues dhe përbërja e Kolegjit shqyrtues të jenë të njëjtë me atë që ishte vendosur nga Kryetarja për caktimin e gjyqtarit raportues dhe Kolegjit shqyrtues më 28 qershor 2017.
21. Më 15 gusht 2017, Gjykata njoftoi parashtruesit përkatës për regjistrimin e kërkesës KI85/17 dhe bashkimin e saj me kërkesat KI73/17 dhe KI78/17.
22. Të njëjtën ditë, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës KI85/17 në Gjykatën Supreme dhe njoftoi Gjykatën Supreme për bashkimin e kërkesave.
23. Më 23 tetor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

24. Ndërmjet 17 majit 2010 dhe 23 tetorit 2014, parashtruesit e kërkesës, në mënyrë individuale parashtruan kërkesa në Gjykatën Themelore kundër Qeverisë së Republikës së Serbisë për kompensimin e dëmeve materiale dhe jomateriale që u shkaktuan atyre ndërmjet viteve 1998 dhe 1999.
25. Ndërmjet 12 korrikut 2013 dhe 2 marsit 2015, Gjykata Themelore, me vendime individuale, hodhi poshtë paditë e parashtruesve të kërkesës dhe u deklarua jokompetente për të vendosur.
26. Parashtruesit e kërkesës u ankuan ndaj vendimeve të Gjykatës Themelore pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Parashtruesit kërkuan që vendimet e Gjykatës Themelore të anulohen dhe kërkesat e parashtruesve të kërkesës të deklarohen të pranueshme.
27. Ndërmjet 12 majit 2015 dhe 14 qershorit 2016, Gjykata e Apelit nxori vendime të ndara, duke refuzuar secilën nga ankesat e parashtruesve të kërkesës dhe duke vërtetuar vendimet e Gjykatës Themelore.
28. Secili nga parashtruesit e kërkesës parashtrroi kërkesa të veçanta për revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Ata kërkuan që revizionet e tyre të aprovohen, vendimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore të anulohen dhe çështja të referohet për rishqyrtim nga Gjykata Themelore.
29. Ndërmjet 7 shkurtit 2017 dhe 20 marsit 2017, Gjykata Supreme nxori vendime të ndara, duke refuzuar revizionet e secilit prej parashtruesve të kërkesës si të pabazuara. Gjykata Supreme në secilin prej vendimeve të veta argumentoi si në vijim:

*“Duke pasur parasysh [dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore] LPK si dhe faktin se me padi është paditur Republika e Serbisë - Qeveria R. S. në Beograd, [...] në rastin konkret fjala është për kontest juridiko-pasuror në shtetin e huaj, vlejné normat e së drejtës ndërkombëtare, për të cilin kontest gjykata e vendit nuk është kompetente për të vendosur, andaj, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson [Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit] në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat e nenit 18.3 dhe nenit 39 par. 1 e 2 të LPK-së, me rastin kur janë shpallë inkompetente për të gjykuar këtë çështje juridike dhe kanë hedhë poshtë padinë [e parashtruesve të kërkesës], ngase e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë, ashtu që, [dhe] selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë si palë e paditur nuk ndodhet në territorin e gjykatave të Republikës së Kosovës.*

*[...]*

*dispozita e nenit 28 të LPK-së, në të cilën thirren [parashtruesit e kërkesës], e me të cilën caktohet kompetenca e gjykatave tona në kontestet me element ndërkombëtar (të huaj), nuk mund të zbatohet në rastin konkret, nga se, këtu nuk kemi të bëjmë as me persona fizikë të huaj, e as me persona juridikë të huaj, por me shtet të huaj, me të cilin deri në momentin aktual shteti i Kosovës në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi, nuk ka të lidhur kurrfarë marrëveshje ndërkombëtare (bilaterale etj.) për kompetencën e gjykatave vendore për këto lloje të kontesteve .*

*Po ashtu, në rastin konkret nuk qëndron as pretendimi i revizionit të [parashtruesve të kërkesës] se në rastin konkret kemi të bëjmë me kompetencën territoriale [të zgjedhur sipas nenit 47, 51 dhe 61] të LPK-së, nga se sipas vlerësimit të [Gjykatës Supreme], këto dispozita nuk kanë të bëjnë me rastin konkret [...], gjykatat e shkallës më të ulët me të drejtë kanë aplikuar dispozitën e nenit 18.3 të LPK-së, duke marrë parasysh edhe arsyet tjera që u theksuan më lart”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

30. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me vendimet e Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 15 të DUDNJ-së.
31. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta “kanë zbatuar gabimisht ligjin e aplikuar referuar juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore [...], nga se, gjykata territorialisht kompetente për gjykime të çështjeve juridike, kurdoherë është gjykata në territorin e së cilës është kryer krimi, dëmtimi moral përkatësisht material! ” Ky definicion e qëndrim juridik valid përkon edhe me interesin e palës së dëmtuar, parimin e ekonomisë në procedurat gjyqësore dhe administrative, si dhe në përputhje me principin ndërkombëtar –për loci”.

32. Parashtruesit e kërkesës, më tej, deklarojnë se atyre nuk u “është dhënë mundësia për t’u trajtuar e njëjta në procedurën ligjore, sipas ligjit të aplikuar të Kosovës, [...] dhe praktikave gjyqësore të mira të rajonit.”
33. Parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar nenit 21, paragrafi 1 të Kushtetutës, pretendojnë se gjykatat e rregullta “nuk i kanë aplikuar standardet e avancuara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Njëra nga standardet është dhënia e mundësisë palës së dëmtuar për inicimin e çështjes së kompensimit të dëmit moral dhe material të shkaktuar si rezultat i veprimit direkt nga ana e autoriteteve serbe”.
34. Parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar nenit 54 të Kushtetutës, gjithashtu deklarojnë se “u është mohuar e drejta për mbrojtje gjyqësore të të drejtave, e drejta për qasje në drejtësi në nivel kombëtar si dhe garancitë institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut”.
35. Parashtruesit e kërkesës iu referohen shembujve që kanë lejuar viktimat e Luftës së Dytë Botërore “të dorëzojnë padi individuale në gjykatat vendore për kompensim të dëmit të shkaktuar nga Gjermania”. Në këtë drejtim, ata specifikojnë se në rastet e Greqisë, Italisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, individëve u është dhënë mundësia për të kërkuar kompensim për “dëmet e shkaktuara nga Gjermania gjatë Luftës së Dytë Botërore në pajtim me parimin ndërkombëtar “për loci”.”
36. Përveç të gjithë parashtruesve të tjerë, parashtruesi i kërkesës Sokol Goxhuli (KI85/17), lidhur me afatin prej 4 (katër) muajve për dorëzimin e kërkesës në Gjykatë, kërkon që afati të kthehet në gjendjen e mëparshme, në pajtim me nenin 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme] të Ligjit, duke theksuar se “nga 10.02.2017 ai e kishte shoqëruar gruan e tij [...] që ishte në kujdesin mjekësor për sëmundjen e kancerit në Francë” dhe kështu nuk kishte mundur ta parashtronte kërkesën brenda afatit të paraparë prej 4 (katër) muajve.

### **Pranueshmëria e kërkesës**

37. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton se:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*(...)*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

39. Gjykata i referohet neneve 49 [Afatet] dhe 50 [Kthimi në gjendjen e mëparshme] të Ligjit, i cili parasheh:

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.*

[...]

*Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj.”*

### **Sa i përket 28 parashtruesve të kërkesës**

40. Gjykata konsideron se 28 parashtruesit e kërkesës, duke mos përfshirë Sokol Goxhulin, rasti i të cilëve do të trajtohet veçmas, janë palë të autorizuar, kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe kanë dorëzuar kërkesat në afatin e paraparë.

41. Megjithatë, Gjykata më tej i referohet nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili parasheh:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

42. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe paragrafëve (1) (d) dhe (2) (d) të rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, të cilët parashohin:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

[...]

*(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.”*

*(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

[...]

*(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.*

43. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta u kanë shkelur shumë të drejta të mbrojtura me Kushtetutë, KEDNJ dhe DUDNJ, kryesisht që kanë të bëjnë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave.



44. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta e kanë interpretuar gabimisht ligjin në fuqi kur i janë referuar juridiksionit territorial të Gjykatës Themelore, duke pretenduar se gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi është gjykatë kompetente për gjykimin çështjet të tyre ligjore.
45. Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesve të kërkesës në thelb kanë të bëjnë me interpretimin nga gjykatat e rregullta të dispozitave procedurale lidhur me kompetencën e tyre territoriale dhe kompetencën për t'u marrë me kërkesat e parashtruesve.
46. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, para. 28).
47. Vërtetimi i plotë i gjendjes faktike dhe aplikimi i drejtë i ligjit është brenda juridiksionit të plotë të gjykatave të rregullta (çështje e ligjshmërisë). Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (Shih: rasti i GJEDNJ-së i 16 shtatorit 1996, *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, para. 65, shih po ashtu *mutatis mutandis*, rasti i Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, 5 prill 2012).
48. Gjykata vëren se Gjykata Supreme ka vlerësuar interpretimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore të dispozitave procedurale në lidhje me kompetencën e tyre për zgjidhjen e kërkesave të parashtruesve.
49. Gjykata Supreme gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës arsyetoi se Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e nenit 18, paragrafi 3 dhe nenit 39, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore kur kanë deklaruar se nuk kanë pasur juridiksion për këto çështje ligjore. Prandaj, Gjykata Supreme hodhi poshtë pretendimet e parashtruesve të kërkesës, sepse juridiksioni i përgjithshëm territorial është në gjykatën në territorin e së cilës është selia e Kuvendit të Republikës së Serbisë dhe që nuk gjendet në territorin e gjykatave të Kosovës.
50. Gjykata Supreme më tej ka specifikuar se në rastin e parashtruesve të kërkesës “*kemi të bëjmë me shtet të huaj, me të cilin deri në momentin aktual shteti i Kosovës në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi, nuk ka lidhur kurrfarë marrëveshje ndërkombëtare (bilaterale) për kompetencën e gjykatave vendore për këto lloje të kontesteve*”.
51. Gjykata konsideron se përfundimet e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme janë arritur pas një shqyrtimi të hollësishëm të të gjitha argumenteve të parashtruara nga parashtruesit e kërkesës. Në këtë mënyrë, parashtruesve iu është dhënë mundësia që në të gjitha fazat e

procedurës të paraqesin argumentet dhe provat të cilat i konsiderojnë të rëndësishme për rastet e tyre.

52. Të gjitha argumentet e parashtruesve, të cilat ishin relevante për zgjidhjen e kontestit, ishin dëgjuar dhe shqyrtuar siç duhet nga gjykatat. Të gjitha arsyet materiale dhe ligjore që lidhen me vendimet e kontestuara u parashtruan në detaje nga parashtruesit e kërkesës dhe Gjykata konkludon se procedurat në gjykatat e rregullta, të shikuara në tërësinë e tyre ishin të drejta (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30).
53. Fakti i thjeshtë se parashtruesit e kërkesës nuk janë të kënaqur me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme apo përmendja e neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, *mutatis mutandis*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, *Abdullah Bajqinca*, KI136/14, paragrafi 33).
54. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë paraqitur në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë, përkatësisht nenet 21 [Parimet e Përgjithshme], 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-së ose neni 15 i DUDNJ-së.

#### **Sa i përket parashtruesit të kërkesës Sokol Goxhuli**

55. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës Sokol Goxhuli (KI85/17) është palë e autorizuar dhe ka shteruar mjetet juridike në dispozicion.
56. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës deklaroi se e ka pranuar aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 416/2016 më 10 shkurt 2017, ndërsa ai e ka dorëzuar kërkesën (KI85/17) në Gjykatë më 27 korrik 2017. Prandaj, Gjykata konsideron se kërkesa e tij është dorëzuar pas afatit prej 4 (katër) muajsh.
57. Në lidhje me këtë, parashtruesi i mësipërm kërkon nga Gjykata kthimin e afatit në gjendjen e mëparshme, në pajtim me nenin 50 të Ligjit, duke deklaruar se “nga 10.02.2017 ai e kishte shoqëruar gruan e tij [...] që ishte në kujdesin mjekësor për sëmundjen e kancerit në Francë”. Kështu, duke marrë parasysh arsyet e mësipërme “ai shpreson që Gjykata do ta aprovojë kërkesën e tij për kthim në gjendjen e mëparshme”.
58. Për të mbështetur argumentet e tij, parashtruesi paraqiti dëshmi prej kur gruaja e tij ishte regjistruar për ekzaminim mjekësor në Francë.

59. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar dëshmi prej kur gruaja e tij ishte kthyer nga ekzaminimi mjekësor në Francë, nëse parashtruesi i kërkesës e shoqëroi atë gjatë këtij udhëtimi, dhe nëse po, si rezultoi kjo gjendje në pamundësinë e tij për të parashtruar kërkesën në Gjykatë ose për të autorizuar një përfaqësues që ta dorëzonte kërkesën në Gjykatë në emër të tij. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka siguruar dëshmi që tregojnë se kërkesa është parashtruar brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga eliminimi i pengesave që arsyetojnë kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme siç kërkohet me nenin 50 të Ligjit.
60. Prandaj, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur kërkesën e tij për kthimin e afatit në gjendjen e mëparshme në pajtim me nenin 50 të Ligjit dhe në këtë mënyrë, kërkesa e tij duhet të refuzohet.
61. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor 4 (katër) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, dhe se vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (Shih rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aplikacioni nr. 23274/04, GJEDNJ, Aktvendimi i 25 gushtit 2005 dhe po ashtu, shih rastin nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 marsit 2014, paragrafi 24).
62. Bazuar në si më sipër, rezulton se kërkesa (KI85/17) e parashtruesit Sokol Goxhuli është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës dhe si e tillë është e papranueshme.
63. Rrjedhimisht, kërkesat:
- i)* përkitazi me të gjithë 28 parashtruesit e kërkesës (KI73/17 dhe KI78/17) janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohen të papranueshme në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës; dhe
- ii)* përkitazi me parashtruesin e kërkesës Sokol Goxhuli (KI85/17) kërkesa e tij ishte dorëzuar jashtë afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës dhe si e tillë është e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenet 48, 49 dhe 50 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (c), 36 (1) (d), 36 (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 tetor 2017, njëzëri


### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi